



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. 9/80 / prot.

Tiranë, më 21, 06, 2018

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZOTIT ALDRIN DALIPI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË

I nderuar zoti kryetar,

Bashkëngjitur ju dërgojmë relacionin dhe projekt-vendimin "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar.

Me respekt,

KRYETARI

Erion VELLA





BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

REALCION

PËR

“DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.59, DATË 30.12.2015, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS” (I NDRYSHUAR)”

Referuara akteve ligjore dhe nënligjore të përshkruara në këtë projekt vendim Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), VKM nr. 50, datë 31.1.2018 “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2018-2020”, VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar i ka paraqitur Kryetarit të Bashkisë Tiranë, sugjerimet dhe argumentet mbi zbatimin e nivelit të ri të taksës së ndërtesës për kategorinë Biznesi dhe kategorinë Familjarë, si më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), dhe VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, për implementimin e taksës së ndërtesës, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e taksës së ndërtesës nga kategoria “Biznesi”;

Baza e llogaritjes së taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës/njesisë pronësore, që llogaritet në përputhje me një nga metodat e parashikuara në metodologjinë e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Detyrimi i taksës mbi ndërtesën është vjetor.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Bashkia Tiranë për qëllime zbatimi të taksës së pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, vepron në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, si edhe çdo akti tjetër nënligjor që normon këtë proces.

Për qëllim të zbatimit të metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, termat e mëposhtëm edhe në zbatim të këtij vendimi të këshillit bashkiak, kanë kuptimin si më poshtë:

- “Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.
- “Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktine miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- “Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
- “Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
- “Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
- “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
- “Nënkatëgoria “Ndërtesa të tjera”, përfshihen ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat e njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë, si dhe objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, pasuri (njësi shërbimi) që nuk shfrytëzohen.

Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, dhe që reflektohen si më poshtë edhe në këtë vendim:

- a. 0,05% për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b. 0,2% për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Çmimi për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të miratuar me vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së

paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, dhe anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Lehtësira dhe përjashtime:

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për nënkategorinë “Ndërtesa të tjera”, është minus 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas ndarjes zonale të Bashkisë Tiranë.

Përjashtohen nga taksat mbi ndërtesën:

- a. Pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c. ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d. banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e. pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g. strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- h. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- i. ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- j. ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.”.

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi sipas qyteteve dhe ndarjes zonale për qytetin e Tiranës

Qyteti/NJA	Nr.	Zona	Lekë/m2 sipërfaqe Shfrytëzimi
Qyteti Tiranë	1	1/1	97.700,00 Lekë
	2	1/2	78.000,00 Lekë
	3	2/1	187.000,00 Lekë
	4	2/2	134.500,00 Lekë
	5	2/3	95.000,00 Lekë
	6	2/4	110.000,00 Lekë
	7	2/5	80.000,00 Lekë
	8	3/1	77.000,00 Lekë
	9	3/2	60.000,00 Lekë
	10	4/1	70.000,00 Lekë
	11	4/2	60.000,00 Lekë
	12	5/1	190.000,00 Lekë
	13	5/2	132.000,00 Lekë
	14	5/3	107.000,00 Lekë
	15	5/4	82.000,00 Lekë
	16	6	65.000,00 Lekë
	17	7/1	120.000,00 Lekë
	18	7/2	100.000,00 Lekë
	19	7/3	85.000,00 Lekë
	20	7/4	65.000,00 Lekë
	21	8/1	110.000,00 Lekë

	22	8/2	100.000,00 Lekë
	23	8/3	72.000,00 Lekë
	24	9/1	130.000,00 Lekë
	25	9/2	100.000,00 Lekë
	26	9/3	77.000,00 Lekë
	27	10/1	145.000,00 Lekë
	28	10/2	139.500,00 Lekë
	29	10/3	102.000,00 Lekë
	30	11/1	87.000,00 Lekë
	31	11/2	75.000,00 Lekë
	32	11/3	70.000,00 Lekë
Njësitë Administrative Bashkia Tiranë	33	Baldushk	32.000,00 Lekë
	34	Bërzhitë	34.000,00 Lekë
	35	Dajt	53.500,00 Lekë
	36	Farkë	66.500,00 Lekë
	37	Kashar	53.500,00 Lekë
	38	Krrabë	28.200,00 Lekë
	39	Ndroq	34.000,00 Lekë
	40	Petrelë	53.500,00 Lekë
	41	Pejë	53.500,00 Lekë
	42	Shëngjergj	23.000,00 Lekë
	43	Vaqarr	34.000,00 Lekë
	44	Zall-Bastar	25.000,00 Lekë
	45	Zall-Herr	28.200,00 Lekë

Deri në saktësimin e informacionit të Kadastrës Fiskale sa referuar dhe pikës 4 Reformat strukturore parësore (Reforma 01) të VKM nr.50, datë 31.1.2018 “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2018-2020”, stuktura e UKT Sha do të vijoj të aplikojnë nivelin e taksës së ndërtesës sipas përcaktimeve të VKB nr. 59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar) dhe marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë Tiranë mbi procedurat e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjarë.

Në pikën I. e. “TAKSA E TABELËS”, tabela që përcakton nivelin e taksës sipas kategorive, ndryshon si më poshtë:

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	deri në 2 m ²	lekë m ² vit	0	0	0
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²	lekë m ² vit	15 000	10 000	7 000
	-e thyeshhtë (pa ndënjim)	lekë m ² vit	20 000	15 000	11 500
	-me ndënjim të thyeshhtë	lekë m ² vit	35 000	20 000	15 000
	-elektronike	lekë m ² vit			
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²	lekë m ² vit	12 750	8 500	5 950
	-e thyeshhtë (pa ndënjim)	lekë m ² vit	17 000	12 750	9 775
	-me ndënjim të thyeshhtë	lekë m ² vit	29 750	17 000	12 750
	-elektronike	lekë m ² vit			
d	mbi 20 m ² deri 40 m ²	lekë m ² vit	8 250	5 500	3 850
	-e thyeshhtë (pa ndënjim)	lekë m ² vit	11 000	8 250	6 325
	-me ndënjim të thyeshhtë	lekë m ² vit	19 250	11 000	8 250
	-elektronike	lekë m ² vit			
e	mbi 40 m ²	lekë m ² vit	6 000	4 000	2 800
	-e thyeshhtë (pa ndënjim)	lekë m ² vit	8 000	6 000	4 600
	-me ndënjim të thyeshhtë	lekë m ² vit	14 000	8 000	6 000
	-elektronike	lekë m ² vit			
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	-Tabela identifikuese	lekë m ² vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thyeshhtë (me pa ndënjim)	lekë m ² vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë m ² vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë m ² ditë	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastrë, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m² shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do të shtohet, shuma e taksës së llogaritur për diferencën e sipërfaqes mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës.P.sh. një tabelë të thejshhtë 15 m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet: (10 m² x 15.000 lekë) + (5 m² x 12.750 lekë) = 150.000 + 63.750 = 213.750 lekë në vit (ose 17.812 lekë në muaj. E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë për sipërfaqet e tabelës mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m² do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhetvetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, tëvendosur në pamjen jo ballore, në taraca, llozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj, qe kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Z. Skënder Haderaj
Përgjegjës, Sektori i të Ardhurave Vendore

Znj. Jonida Halili
Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar


Z. Mexhit Doçi
Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Znj. Enola Bejko
Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Znj. Laura Deliu
Drejtor, Drejtoria Juridike

Z. Alban Dokushi
Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit

Arbjan Mazniku
Zv. Kryetar

P. Aliu


Esmeralda Demiraj
Jurist, Keshilli Bashkiak

Behar Zeneli
Sekretar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë ____/____/2018

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.59, DATË 30.12.2015, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), VKM nr. 50, datë 31.1.2018 “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (ERP) 2018-2020”, VKM nr. 132 datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Tiranë,

V E N D O S I:

Në vendimin nr.59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika I.a.1 Taksa mbi ndërtesën, ndryshohet si më poshtë:

“I.a.1 TAKSA MBI NDËRTESEN”.

1. Baza e llogaritjes së taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës/njesisë pronësore, që llogaritet në përputhje me një nga metodat e parashikuara në metodologjinë e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Detyrimi i taksës mbi ndërtesën është vjetor. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

3. Bashkia Tiranë për qëllime zbatimi të taksës së pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, vepron në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, si edhe çdo akti tjetër nënligjor që normon këtë proces.

4. Për qëllim të zbatimit të metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, termat e mëposhtëm edhe në zbatim të këtij vendimi të këshillit bashkiak, kanë kuptimin si më poshtë:

- “Ndërtesë”, objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

- “Ndërtesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktine miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

- “Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

- “Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

- “Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

- “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

- “Nënkategoria “Ndërtesa të tjera”, përfshihen ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat e njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë, si dhe objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, pasuri (njësi shërbimi) që nuk shfrytëzohen.

5. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, dhe që reflektohen si më poshtë edhe në këtë vendim:

a. 0,05% për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b. 0,2% për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

c. 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

6. Çmimi për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të miratuar me vendimin nr. 132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, dhe anekseve bashkëlidhur këtij vendimi.

Lehtësira dhe përjashtime:

Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për nënkategorinë “Ndërtesa të tjera”, është minus 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas ndarjes zonale të Bashkisë Tiranë.

Përfshihen nga taksat mbi ndërtesën:

- Pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.”.

2. Në pikën I. e. “TAKSA E TABELËS”, tabela që përcakton nivelin e taksës sipas kategorive, ndryshon si më poshtë:

Aneksi 7

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE

Nr	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashki Kat.I	Bashki Kat.II	Bashki Kat.III
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	deri në 2 m ²	lekë m ² /vit	0	0	0
b	mbi 2 m ² deri 10 m ²	lekë m ² /vit			
	-e thjeshtë (pa ndënjim)	lekë m ² /vit	15 000	10 000	7 000
	-me ndënjim të thjeshtë	lekë m ² /vit	20 000	15 000	11 500
	-elektronike	lekë m ² /vit	35 000	20 000	15 000
c	mbi 10 m ² deri 20 m ²	lekë m ² /vit			
	-e thjeshtë (pa ndënjim)	lekë m ² /vit	12 750	8 500	5 950
	-me ndënjim të thjeshtë	lekë m ² /vit	17 000	12 750	9 775
	-elektronike	lekë m ² /vit	29 750	17 000	12 750
ç	mbi 20 m ² deri 40 m ²	lekë m ² /vit			
	-e thjeshtë (pa ndënjim)	lekë m ² /vit	8 250	5 500	3 850
	-me ndënjim të thjeshtë	lekë m ² /vit	11 000	8 250	6 325
	-elektronike	lekë m ² /vit	19 250	11 000	8 250
d	mbi 40 m ²	lekë m ² /vit			
	-e thjeshtë (pa ndënjim)	lekë m ² /vit	6 000	4 000	2 800
	-me ndënjim të thjeshtë	lekë m ² /vit	8 000	6 000	4 600
	-elektronike	lekë m ² /vit	14 000	8 000	6 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim				
	Tabela identifikuese	lekë m ² /vit	120	120	120
III.	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		Bashkia Tiranë	Bashkia Durrës dhe gjithë bashkitë e tjera të Kat.II	Bashkitë e Kat.III
	-e thjeshtë (me pa ndënjim)	lekë m ² /vit	45 000	22 500	13 500
	-Elektronike	lekë m ² /vit	90 000	45 000	27 000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.				
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë m ² /date	1 000	1 000	1 000

Shënim: Bashkitë sipas kategorive ndahen:

Kategoria I: Tiranë, Durrës

Kategoria II: Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Berat, Korçë, Pogradec, Sarandë, Lushnjë, Gjirokastër, Lezhë, Krujë.

Kategoria III: Të gjitha bashkitë e tjera.

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m² shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do ti shtohet, shuma e taksës së llogaritur për diferencën e sipërfaqes mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.sh. një tabelë të thejstë 15 m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet: (10 m² x 15.000 lekë) + (5 m² x 12.750 lekë) = 150.000 + 63.750 = 213.750 lekë në vit (ose 17.812 lekë në muaj. E njëjta llogjikë llogaritje do të jetë për sipërfaqet e tabelës mbi 20 m² dhe mbi 40 m².

Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese, vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë, kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë.

Çdo tabelë reklamimi që kalon sipërfaqen 35 m² do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe, pavarësisht madhësisë së saj në m².

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet, formë promovimi që shërben për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit, të vendosur në pamjen jo ballore, në taraca, llozhë, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj, që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

3. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet mjeteve të informimit publik të informoj tatimpaguesit në lidhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ujësjetës Kanalizime Sha Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2018.

KRYETAR

ALDRIN DALIPI